“Merr prej pasurisë së tij aq sa është e njohur zakonisht se mjafton për ty dhe fëmijët e tu!”

Aishja, nëna e besimtarëve (Allahu qoftë i kënaqur me të!) tregon: “Hind bint Utbe, gruaja e Ebu Sufjanit, hyri tek i Dërguari i Allahut ﷺ dhe i tha: “O i Dërguari i Allahut! Ebu Sufjani është njeri koprrac, andaj nuk më jep aq sa më mjafton për vete dhe për fëmijët e mi, përveç aq sa marr vetë pa dijen e tij. A kam ndonjë mëkat për këtë? I Dërguari i Allahut ﷺ i tha: “Merr prej pasurisë së tij aq sa është e njohur zakonisht se mjafton për ty dhe fëmijët e tu!”

[Sahih] [Muttefek alejhi]

Hind bint Utbe (Allahu qoftë i kënaqur me të!) kërkoi këshillën e Profetit ﷺ në lidhje me bashkëshortin e saj, Ebu Sufjanin (Allahu qoftë i kënaqur me të!), i cili ishte njeri koprrac dhe shumë i kujdesshëm për pasurinë e tij. Ai nuk i siguronte asaj dhe fëmijëve të saj aq sa u mjaftonte, përveçse kur ajo merrte fshehurazi nga pasuria e tij pa dijeninë e tij. Ajo e pyeti nëse kishte ndonjë mëkat mbi të për këtë. Profeti ﷺ i tha: "Merr nga pasuria e tij për veten tënde dhe për fëmijët e tu aq sa është e njohur zakonisht se mjafton, edhe pa dijeninë e tij."

http://sunnah.global/hadeeth/sq/show/2965